


ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



RAPORT VJETOR

2 0 1 0

© Në këtë Raport janë përdorur fotografi të marra nga albumi
“Archaeological Treasures from Albania”, nga Neritan Ceka.
Është i ndaluar shumëzimi ose përhapja e tyre pa lejen e autorit.

Design & Layout: Sonila Krashi

Shtypi: Gent Grafik

ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



RAPORT VJETOR

2 0 1 0



Kisha e Shën Mërisë në Manastirin e Apollonisë, shek. XIII.

Përmbajtja

• Mesazh nga Kryetari	7
• Profili i AAB-së	8
• Struktura Organizative	8
• Sistemi bankar shqiptar gjatë vitit 2010	11
• Aktiviteti i AAB-së në vitin 2010	15
• I. Çështje Rregullatore Bankare	15
• II. Aktiviteti i Komiteteve të AAB-së	18
• III. Aktivitetet Operacionale të AAB-së	24
• IV. Bankat Anëtare	34
• V. Aktiviteti Financiar i AAB-së	37



Harku i kriptës së bazilikës paleokristiane të 40 Shenjtorëve në lartësitë mbi qytetin e Sarandës. Shek. VI m. Kr.

MESAZH NGA KRYETARI



Të nderuar Kolegë,

Ndër të dëmtuarit nga kriza financiare globale ishin bankierët dhe veprimtaria bankare, si rrjedhojë e imazhit të keq që u krijua rreth tyre. Në shumicën e rasteve dhe shteteve, kjo mund të justifikohet; por në Shqipëri ne nuk meritojmë asnjë njollë të vetme në reputacionin tonë si sistem bankar dhe as si bankierë. Bankat në Shqipëri nuk kanë aktive të rrezikshme në bilancet e tyre, dhe as nuk janë joshur për huadhënie të pakujdesshme. Shqipëria që ajo që vuajti më pak nga kriza në rajon dhe kjo pjesërisht falë sistemit bankar. Shoqata jonë do ta ketë prioritet për vitin 2011 që ta bëjë këtë sa më të qartë për autoritetet dhe publikun.

Së dyti, nevojitet që të ndryshojmë Statutin për të siguruar një strukturë ekzekutive/mbikëqyrëse gjithmonë përfaqësuese, e cila do të jetë kështu edhe më e pranishme dhe më e fortë. Ka kaluar shumë kohë që nga miratimi i Statutit të parë – kur unë isha përsëri Kryetari – dhe koha ka treguar që tani ne kemi nevojë për ndryshime.

Së treti, ne kemi disa çështje reale dhe të pashmangshme me autoritetet, që variojnë nga vështirësitë në ekzekutimin e detyrueshëm të kolateralit dhe procedurat me hipotekat deri në kërkesat e provizionimit dhe tatimin selektiv. Disa prej këtyre çështjeve i kanë rrënjët në kuadrin ligjor në zhvillim në vend, ndërsa disa të tjera e kanë origjinën nga kriza. Megjithatë, të gjitha së bashku ato kanë pasojë për sistemin tonë dhe duhet të ndiqen me profesionalizëm.

Së katërti, AAB është e pozicionuar në mënyrë unike për të organizuar programe trajnimi për bankierët, programe të cilat nuk do të kishin kuptim ekonomikisht nëse bankat do t'i zhvillonin ato individualisht.

Është e tepërt të thuhet që pjesa më e madhe e sfidave të mësipërme kërkon më shumë financim nga bankat anëtare, financim ky që mund të ndahet sipas madhësisë së tyre.


Në mbyllje, do të doja të falënderoja Sekretariatit e Përgjithshëm për punën e mrekullueshme gjatë vitit 2010, si dhe anëtarët e Bordit Drejtues dhe paraardhësit e mi për kontributin e tyre të paçmueshëm.

Me respekt,

Seyhan Pencapligil

STRUKTURA ORGANIZATIVE

ASAMBLEJA A ANËTARËVE TË AAB-SË



NDRYSHIME ORGANIZATIVE GJATË VITIT 2010

Me dorëheqjen e Z. Catalano nga pozicioni i Kryetarit të AAB-së, në mbledhjen e Asamblesë, në Maj të vitit 2010 u organizuan zgjedhje të reja. Asambleja e Anëtarëve zgjodhi si Kryetar të ri të AAB-së z. Gazmend Kadriu, i cili mbajti pozicionin e Kryetarit deri në fund të mbarimit të mandatit në Janar 2011. Në mbledhjen e Janarit 2011 Asambleja zgjodhi si Kryetar të ri (aktual) Z. Seyhan Pencapligil.

Duke vlerësuar ngarkesën e punës në Sekretariatit e AAB-së (veçanërisht pas përfundimit të SPI-Shqipëri dhe marrjes përsipër të projekteve të saj) me vendim të Bordit Drejtues marrë në Korrik 2010, strukturës organizative të Sekretariatit të AAB-së iu shtua një pozicion Specialisti, me emërtimin Specialist Operacionesh, përgjegjësitë kryesore të të cilit do të jenë të krijojë dhe mbajë marrëdhënie me partnerët e AAB-së, të koordinojë dhe organizojë trajnime për komunitetin bankar, dhe të shërbejë si koordinator për disa nga Komitetet Permanente ekzistuese të AAB-së dhe atyre që mund të krijohen në të ardhmen.

Gjatë vitit 2010 u krijuan dy Komitete të reja teknike, Komiteti i Përputhshmërisë dhe ai i Sigurisë së Informacionit, ndërsa Komitetit i Pagesave u riaktivizua pas një viti ndërprerjeje të aktivitetit të tij.

BORDI DREJTUES I AAB-SË (NË QERSHOR 2011)



Z. Seyhan PENCAPLIGIL
Drejtor i Përgjithshëm,
Banka Kombëtare Tregtare

Kryetar

Z. Christian CANACARIS
Drejtor i Përgjithshëm,
Raiffeisen Bank – Shqipëri

Anëtar

Zj. Flutura VEIPI
Zëdhënëse e Bordit Drejtues,
Procredit Bank – Shqipëri

Anëtare

Mr. Ioannis KOUGIONAS
Drejtor i Përgjithshëm , Banka
Kombëtare e Greqisë – Shqipëri

Zëvendës Kryetar

Mr. Andreas A. GALATOULAS
Drejtor i Përgjithshëm,
Alpha Bank – Shqipëri

Anëtar



Butrint. Porta e Luanit; ndërtuar rreth vitit 380 p. Kr dhe rindërtuar rreth vitit 230 p. Kr. Relievi i një periudhe më të hershme paraqet një luan që copton kokën e një kau.

SISTEMI BANKAR SHQIPTAR GJATË VITIT 2010



Ekonomia Shqiptare pati një performancë përgjithësisht pozitive gjatë vitit 2010, me stabilitet financiar të konsoliduar, rikthim të besimit të publikut në sistemin financiar dhe zgjerim të mëtejshëm të ndërmjetësimit financiar.

Performanca e mirë e ekonomisë u reflektua në një vit përgjithësisht më të mirë për situatën financiare të sistemit bankar, krahasuar me 2009. Ajo u karakterizua nga likuiditet dhe aftësi e mirë paguese, rritje më e madhe e aseteve të bankave, rritje e veprimtarisë kredituese, dhe performancë më e mirë financiare, pavarësisht rritjes së kredive me probleme.

Në fund të vitit 2010, sektori bankar Shqiptar përbëhej nga 16 banka tregtare tërësisht private, dhe mbetej aktori kryesor në sektorin financiar në Shqipëri. Bankat Shqiptare mbeten me një strukturë të thjeshtë të burimeve të tyre kryesisht nga depozitat e financim të jashtëm të kufizuar, dhe shumicën e investimeve të tyre në kredi dhe vendosje me bankat e tjera.

Tabelë I. Treguesit e Performancës së Sistemit Bankar Shqiptar

Tregues	2009	2010
Total i aseteve (miliard LEK)	886.3	990.6
në % të PBB-së	77.5 %	88.1 %
Totali i Depozitave (miliard LEK)	694.3	816.7
në % të PBB-së	60.7 %	72.6 %
Kreditimi i Ekonomisë (miliard LEK)	449.4	490.9
në % të PBB-së	39.3 %	43.7 %
Kapitali i Aksionerëve (miliard LEK)	84.8	93.1
Fitimi (miliard LEK)	3.54	6.7

Burimi: Banka e Shqipërisë

Asetet e sistemit bankar u rritën me një ritëm më të lartë në vitin 2010, si në vlerë nominale ashtu edhe për nga kontributi i tyre në Produktin e Brendshëm Bruto. Në krahasim me 2009 gjatë 2010 totali i aseteve të bankave u rrit me rreth 12 për qind, duke përbërë 81 për qind të PBB-së së vendit.

Në fund të vitit 2010, depozitat patën peshë më të madhe në financimin total të sistemit bankar, duke u përlogaritur rreth 82 për qind të totalit të aseteve, krahasuar me 78 për qind në Dhjetor 2009. Në përgjithësi, depozitat arritën nivelin e tyre të para-krizës në Qershor të vitit 2010 dhe patën një rritje të rëndësishme me rreth 18 për qind gjatë vitit. Raporti i depozitave ndaj PBB-së ishte 64.2 për qind në fund të vitit, edhe më i lartë se niveli i tij para tërheqjes së depozitave. Profili i strukturës së maturimit të depozitave ndryshoi drejt depozitave me maturim afat-gjatë, duke treguar një rritje të preferencës për kursim.

Tabelë 2. Struktura e Depozitave

(Në mijë Lek, %)	31.12.2009	31.12.2010	Ndryshimi vjetor
Total i depozitave	694,258	816,734	18%
Depozitat e individëve	592,689	692,030	17%
Depozitat e korporatave	101,570	124,704	23%

Burimi: Banka e Shqipërisë

Kreditimi u përlogarit në rreth 49 për qind të aseteve të sistemit në Dhjetor të vitit 2010, me një rritje prej rreth 9 për qind gjatë vitit. Rritja modeste ishte pasojë e kërkesës së ulët për kredi nga agjentët ekonomik, por edhe e politikave të kujdesshme të kreditimit nga bankat, të cilat i kushtuan më shumë vëmendje cilësisë së portofolit të tyre të kredisë. Kreditimi mbështeti kryesisht investimet në sektorët e shërbimeve dhe industrisë, ndërsa kredia konsumatore shfaq normë mesatare rritjeje.

Kreditë e reja të akorduara nga bankat gjatë vitit 2010 ishin në total rreth 19 për qind më shumë se kreditë e akorduara gjatë vitit 2009. Struktura e maturimit të huave të reja tregon se bankat janë më shumë të fokusuar në huadhënien afat-shkurtër. Në fakt, huatë afat-shkurtra përbënin rreth 60 për qind të huave të reja gjatë vitit 2010, duke reflektuar nevojën e ekonomisë për likuiditet në situatën pas krizës financiare globale.

Tabelë 3. Klasifikimi i Huave

(Në mijë LEK, %)	31.12.2009	31.12.2010	Ndryshimi vjetor
Hua (Principal + Interesa)	449,891	490,870	9%
Hua Standarde	338,815	358,055	6%
Hua me Referim të Veçantë	28,570	34,598	21%
Hua Nënstandarde	21,330	30,290	42%
Hua të Dyshimta	12,297	17,973	46%
Hua të Humbura	13,491	20,256	50%
Të tjera	35,390	29,698	-16%
Hua për individë	144,474	147,753	2%
Hua për Korporata	305,418	343,117	12%

Burimi: Banka e Shqipërisë

Huatë me probleme vazhduan të rriten gjatë vitit 2010, duke kulmuar në Nëntor 2010 në 14.4 për qind të totalit të huave, dhe duke rënë nga fund i Dhjetorit në 14 për qind. Në fakt, ritmi i përkeqësimit të treguesit të cilësisë së huave ka rënë krahasuar me një vit më parë, si rezultat i normës më të lartë të rritjes së totalit të huave. Megjithatë, risku i kredisë mbetet risku kryesor i sistemit bankar, i reflektuar edhe në fondet e mëdha rezervë që krijohen për të mbuluar humbjet e mundshme. Në fund të vitit 2010, provizionet për riskun e kredisë në huadhëniet për rezidentët ishin rreth 33 për qind më të larta se në fund të vitit 2009.

Pavarësisht nga risku i lartë i kredisë dhe fondet rezervë të rritura, fitimi vjetor neto për vitin 2010 arriti në 6,7 Miliard Lek, ose rreth 90 për qind më e lartë se shifra e vitit të kaluar.

Sistemi Bankar Shqiptar vazhdoi të ishte i mirë-kapitalizuar dhe likuid gjatë vitit 2010. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit ishte 15.4 për qind në Dhjetor 2010, pak më i ulët se niveli i fundvitit 2009, megjithatë përtej nivelit minimal prej 12 për qind të përcaktuar nga kuadri rregullator.

Raporti i huave ndaj depozitave u ul në 60 për qind në fund të vitit 2010, çka sugjeron që sektori bankar ka mjaftueshëm kapacitet të brendshëm për tu rritur, pa nevojën e mbështetjes në financim të jashtëm.

Injektimi i fondeve në kapitalin e bankave u reflektua në një rritje prej 8.2 Miliard Lek, në një shumë totale të kapitalit aksioner prej 93.1 Miliard Lek ose 9.4 për qind e totalit të asetëve bankare.

Bankat zgjeruan dhe riorganizuan aktivitetin e tyre gjatë vitit 2010 nëpërmjet hapjes së degëve dhe agjencive të reja dhe mbylljes së disa prej ekzistueseve. Veç kësaj, pati një rritje të rëndësishme në numrin e ATM-ve dhe POS-eve, dhe Kartave të Pagesave të emetuara, duke u siguruar klientëve më shumë akses ndaj shërbimeve dhe produkteve bankare dhe financiare.

Tabelë 4. Rrjeti i shërbimeve bankare

Treguesi	2009	2010
Nr. i Degëve	533	548
Nr. i ATM-v	741	771
Nr. i POS-eve	4,370	4,903
Nr. i Kartave	566,985	694,848
- debi	543,141	667,548
- kredi	23,844	27,300

Burimi: Banka e Shqipërisë, AAB.

SEKRETARIATI I AAB-SË



ZJ. ENDRITA XHAFERAJ

Filloi punë në Shoqatën Shqiptare të Bankave më 1 Tetor 2009. Ajo është aktualisht Sekretare e Përgjithshme e AAB-së.



ZNJ. BRUNILDA KOSTARE

Filloi punë në Shoqatën Shqiptare të Bankave më 1 Nëntor 2004. Ajo është aktualisht Këshilltare Ligjore e AAB-së.



ZNJ. JUNIDA KATROSHI

Filloi punë në Shoqatën Shqiptare të Bankave më 1 Korrik 2005. Ajo është aktualisht Specialiste Operacionesh në AAB.



ZJ. MARSELA BULKU

Filloi punë në Shoqatën Shqiptare të Bankave më 1 Korrik 2010. Ajo është aktualisht Asistente Administrative e AAB-së.

Që prej vitit 2003, Sekretariati ka funksionuar si strukturë e veçantë duke shënuar një hap përpara, në drejtimin e duhur të AAB-së në përputhje me parimet ndërkombëtare të shoqatave të bankave. Sekretariati i AAB-së gjithmonë ka punuar për të krijuar dhe nxitur diskutime të frytshme dhe një profil konsultativ në rritje për autoritetet rregullatore dhe vendim marrëse lidhur me çështjet kryesore të sistemit bankar shqiptar. Fokusi ynë mbetet lehtësimi i procesit të komunikimit brenda vetë sistemit bankar dhe me autoritetet e ndryshme rregullatore, krijimi i më shumë komiteteve të përhershme teknike si dhe sigurimi i mundësive për trajnime kosto-efektive dhe lehtësirave për bankierët Shqiptarë.

ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



Blvd. "Dëshmorët e Kombit"
Kullat Binjake, Kulla I, kati VI, Ap.A3
Tel: +355 4 22 80 371; Fax. +355 4 22 80 359
e-mail: sekretariat@aab-al.org;
web: www.aab.al

AKTIVITETI I AAB-SË NË VITIN 2010



I. ÇËSHTJE RREGULLATORE BANKARE

1. PROPOZIM PËR NDRYSHIMIN E SKEMËS SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Një nga shqetësimet e sistemit bankar gjatë 2010-ës ishte ndikimi në kostot e bankave i ndryshimeve në Ligjin “Mbi sigurimin e Depozitave” lidhur me ngritjen e pragut maksimal të sigurimit të depozitave nga 700.000 Lek në 2.500.000 Lek, duke mbajtur ndërkohë në të njëjtën vlerë primin e sigurimit. Sekretariati i AAB-së krijoi një grup pune me ekspertë të bankave Anëtare që u mbledh në takime të ndryshme gjatë fundit të vitit 2009 dhe fillimit të vitit 2010. Në vijim të diskutimeve dhe kontributit në takimet e grupit të punës, Sekretariati i AAB-së përgatiti një material përmbledhës që mbështeste propozimin bërë Autoriteteve për të konsideruar futjen e një metode të re të kalkulimit të primit të sigurimit të depozitave. Materiali paraqet një analizë të plotë mbi efektet e zbatimit të ndryshimeve të ligjit “Mbi Sigurimin e Depozitave” në sektorin Bankar Shqiptar, dhe masat për amortizimin e efekteve të mundshme negative. Mbas rishikimit nga Bordi Drejtues i AAB-së, materiali iu dërgua fillimisht Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, si autoriteti përgjegjës, dhe më pas Bankës së Shqipërisë. Asnjë nga Institucionet nuk ktheu një përgjigje zyrtare gjatë vitit, megjithatë diskutime të mëtejshme u zhvilluan në okazione të ndryshme, siç ishte dhe mbledhja ndërmjet Drejtuesve të Bankës së Shqipërisë dhe Drejtorëve të Bankave zhvilluar në Nëntor të 2009, ku BSH nuk mbajti asnjë qëndrim përfundimtar.

2. NDRYSHIME NË LIGJIN MBI PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE

Në fund të vitit 2009, AAB i propozoi Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave (DPPPP), duke vënë në dijeni edhe Ministrin e Financave dhe Governorin e Bankës së

Shqipërisë, rishikimin dhe ndryshimin e ligjit mbi “Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit”. Në shkurt të vitit 2010, Ministria e Financave i kërkoi AAB-së komente dhe opinione mbi projekt-ligjin për “Shtesa dhe ndryshime të ligjit Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”. Në këtë projektligj, autoritetet përkatëse kishin propozuar ndryshimin e nenit 27, ku penaliteti për transaksionet e paraportuara nga bankat ulej nga 10-50% në 5-20% të shumës së transaksioneve të paraportuara nga Bankat, çështje në lidhje me të cilën AAB kishte apeluar për shuma fikse dhe të matshme gjobash.

Mbështetur në kontributin dhe argumentat dhënë nga anëtarët e Komitetit Ligjor të AAB-së, Sekretariati i AAB-së përgatiti materialin me komentet dhe sugjerimet e sistemit bankar mbi Projektligjin e propozuar, si dhe ndryshime të tjera të mundshme të Ligjit ekzistues, duke theksuar si shumë të rëndësishëm rishikimin e nenit 27 të ligjit ku citohen vlerat e gjobave. Sugjerimet e AAB-së u morën në konsideratë dhe drafti final i Ligjit (miratuar në Parlament në Mars të vitit 2011) përcakton që gjobat variojnë nga 300,000 LEK deri në 5,000,000 LEK.

3. NDRYSHIMI I LIGJIT PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT

Në cilësinë e anëtarit të Këshillit Konsultativ të Biznesit (KKB), AAB-së iu paraqit në Tetor 2010 një draft propozim për ndryshime në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, për t’u komentuar e diskutuar më pas në mbledhjen e ardhshme të KKB-së. Ndryshimi më i rëndësishëm i propozuar në këtë draft ishte ai në Nenin 25 “Mbi rezervat ligjore për bankat dhe kompanitë e sigurimeve”, në drejtim të mosnjohjes së provizioneve të krijuara nga bankat si shpenzime të zbritshme për qëllime tatimore.

Drafti u diskutua në fillim nga anëtarët e Bordit Drejtues të AAB-së dhe më pas nga gjithë Drejtorët e Bankave, që ranë dakord që AAB duhet të kundërshtojë fuqishëm ndryshimin në nenin 25. Në mbledhjen përkatëse të KKB-së, Sekretarja e Përgjithshme e AAB-së u përcollti të pranishmëve (ndër ta Zëvendës Ministri i Financave dhe përfaqësues të tjerë të Qeverisë) argumentet e sistemit bankar mbledhur nga gjithë Drejtorët e Bankave. Në një mbledhje pasuese me Zëvendës Ministrin e Financave, Z. Kadriu – në atë kohë Kryetar i AAB-së - dhe përfaqësues të tjerë të AAB-së ritheksuan argumentet e dhënë nga bankat dhe të paraqitura në mbledhjen e KKB-së.

Si rezultat i takimeve dhe diskutimeve të anëtarëve të Bordit Drejtues dhe anëtarëve të tjerë të AAB-së me Ministrinë e Financave dhe autoritete të tjera, ndryshimet në Ligj të aprovuara nga Parlamenti në fund të Dhjetorit 2010 përfshinë edhe komentet e AAB-së lidhur me nenin 25, ndaj provizionet për kreditë e humbura në përputhje me SNRF-të mbeten shpenzime të zbritshme.

4. KUADRI RREGULLATOR I BANKËS QENDRORE

• Rregullorja për Rreziqet e mëdha të Bankave

Në fund të viti 2009 AAB kishte kërkuar mundësinë e rishikimit të Rregullores “Për Administrimin e Rrezikut nga Ekspozimet e Mëdha të Bankave”, në drejtim të rikthimit të saj në versionin para krizës dhe kthimin e limitit total të transaksioneve të bankave me mëmat dhe filialet në nivelin e mëparshëm në vend të nivelit 10 për qind mbi kapitalin rregullues të bankës.

Në vitin 2010 Banka e Shqipërisë shprehu gatishmërinë për të diskutuar ndryshimet e mundshme, pasi AAB të dërgonte shqetësimet e detajuara dhe konkrete të bankave. Kështu, Sekretariati i AAB-së mblodhi opinionet nga ekspertët e Bankave Anëtare dhe përpiloi një letër të detajuar me gjithë argumentet dhe propozimet, e cila pas miratimit nga Bordi Drejtues i AAB-së iu dërgua BSh-së.

Në dhjetor të vitit 2010, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi ndryshimet në Rregulloren e lartpërmendur, sipas së cilës limiti i ekspozimit të bankave me bankën mëmë dhe filialet u rrit në 20 për qind të kapitalit rregullator të Bankës.

• Rregullorja për Sigurinë në Banka

Në mars të vitit 2010, përfaqësues të Komitetit të AAB-së për Sigurinë Bankare u takuan me Drejtorin Departamentit të Sigurisë dhe Mbrojtjes dhe përfaqësues të Departamentit të Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë, në lidhje me mundësinë e rishikimit të rregullores Nr. 91 të BSh-së "Për kriteret minimale të sigurisë së ambienteve në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare". Të pranishmit në mbledhje diskutuan rreth propozimeve të AAB-së lidhur me disa ndryshime me qëllim lënien në zgjedhjen e Bankave të detajeve teknike të sistemeve të tyre të sigurisë.

Në vijim, u krijua një grup pune me përfaqësues të departamenteve përkatës në BSH për të rishikuar rregulloren. Ky grup pune mori në konsideratë propozimet dhe sugjerimet e dhëna nga AAB, dhe në fillim të qershorit dërgoi një draft të rishikuar të rregullores për diskutim në mbledhjen e Komitetit të AAB-së për Sigurinë Bankare, në të cilin ishin përfshirë shumica e sugjerimeve të AAB-së. Pak komente shtesë u bënë mbi këtë draft, dhe rregullorja e re u miratua nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në Janar 2011.

Bashkëpunimi me Bankën e Shqipërisë për këtë çështje rezultoi shumë i frytshëm dhe drafti i ri i rregullores, rezultat i këtij bashkëpunimi, paraqet shumë ndryshime në interesin më të mirë të Bankave.

• Rregullorja për Administrimin e Rrezikut të Kredive

Siç ishte diskutuar në disa mbledhje të Bordit Drejtues, Asamblesë së Anëtarëve dhe forume e okazione të tjera, me qëllim përmirësimin e klimës së kreditimit dhe rritjen e mbështetjes së bankave për komunitetin e biznesit dhe individët, Shoqata Shqiptare e Bankave, në emër të gjithë Bankave Anëtare, kërkoi mbështetjen e Bankës së Shqipërisë për lehtësimin e rregullave dhe procedurave të provizionimit të huave.

Në maj 2010, AAB i dërgoi një shkresë Bankës së Shqipërisë ku propozonte disa masa, veçanërisht për lehtësimin e procedurave të ristrukturimit të huave, çka do të ndihmonte bankat të mbështesin klientët me stabilitet financiar dhe dëshirë për të paguar e bashkëpunuar me bankën, si dhe për marrjen në konsideratë të kolateralit në klasifikimin e kredive.

Diskutime të mëtejshme mbi çështjen vijuan në okazione të tjera, veçanërisht në takimin mes Drejtorëve të BSh-së dhe Drejtorëve të Bankave mbajtur në Nëntor 2010. Megjithatë, drafti i ndryshuar i rregullores që iu paraqit bankave në fillim të 2001 nuk kishte marrë parasysh kërkesat e lartpërmendura.

II. AKTIVITETI I KOMITETEVE TË AAB-SË

1. KOMITETI I AAB-SË PËR SIGURINË BANKARE



Z. Bajram IBRAJ
Asistent i Zv. Presidentit
Përgjegjës i Departamentit të
Sigurisë Fizike
Intesa Sanpaolo Bank, Shqipëri

I dashur Lexues,

Kur flet për SIGURINË, ashtu si për çdo fushë, profesion apo detyrë tjetër, duhet referuar historisë njerëzore, dhe nëse profesionet e tjera datojnë me data dhe vite konkrete, Siguria është shumë e hershme, ajo e ka burimin tek nëna që në momentin e parë të lindjes së njëriut. Në vitin 1949, Anna Freud shkruante: “Në 6-mujorin e parë fëmija ka nevojë për 4 gjëra, siguri, ushqim, ngrohtësi dhe veshje të thata.”

Në fushën e sigurisë mund të zgjidhen 95% të problemeve vetëm me 5% përpjekje; prandaj kërkohet më shumë vëmendje, mbështetje financiare dhe investime për personelin dhe sigurinë. Garantimi i sigurisë gjithmonë është çështje urgjente dhe jashtëzakonisht e vështirë. Nuk duhet harruar se 78% e shkeljeve në institucione, pra edhe në banka ndodhin nga personeli, dhe kjo përbën 78% rrezik potencial të sigurisë së brendshme duke përfutur nga këto shkelje elementi kriminal dhe keqbërës. Pra vetëm në 22% të rasteve ekziston rreziku i sulmit nga jashtë. Prandaj, është esenciale që punonjësit e bankave të mos jenë vetëm konsumues të sigurisë, por edhe prodhues të saj, nëpërmjet zbatimit të plotë të rregullave të sigurisë dhe vlerësimit të çdo dyshimi për cënim të sigurisë, dhe bashkëpunimit të menjëhershëm me drejtuesit e departamentit të Sigurisë.

Në këtë frymë, bashkëpunimi i personave përgjegjës për sigurinë fizike të 16 Bankave anëtare të AAB-së, me mbështetjen e Sekretariatit të AAB-së, ngritën në qershor të vitit 2008, Komitetin e AAB-së për Sigurinë Bankare. Viti 2009 ishte viti që hodhi bazat e përfshirjes, njohjes mes kolegësh dhe përkundrejt institucioneve të tjera. Në vitin 2010, Komiteti u konsolidua nëpërmjet bashkëpunimit të frytshëm dhe përgjegjshmërisë së çdo anëtari për nevojën e shkëmbimit të informacionit mbi ngjarjet me të cilat u ndesh siguria bankare. Gjate këtij viti u organizuan gjithsej 12 takime, dyfishi i atyre të parashikuara në planin vjetor të punës së Komitetit.

Unë dëshiroj të sfidoj të gjithë ata që mendojnë që Siguria nuk sjell fitime në Bankë, por vetëm rrit koston dhe shpenzimet. Lajmi i mirë është që Siguria, ashtu si realiteti shoqëror, ekzekutiv dhe ligjor në Banka, po funksionon gjithnjë e më mirë. Drejtuesit e strukturave të sigurisë në banka, janë të angazhuar dhe bashkëpunojnë midis tyre në shkëmbim informacioni për ngjarje dhe situata të ngjashme si dhe bashkëpunojnë ngushtë me strukturat e tjera të Sigurisë në vend. Kjo ka ndikuar ndjeshëm në parandalimin e ngjarjeve kriminale dhe uljen e humbjeve në Banka.

Fokusi ynë për vitin 2011 do të jetë përmirësimi i imazhit të sigurisë në bankë dhe gjithë sistemit në përgjithësi. Objektivi i Komitetit për të ardhmen mbetet bashkëpunimi me drejtuesit e Bankave për rritjen e vëmendjes ndaj forcimit dhe mbështetjes së strukturave të sigurisë dhe përmirësimit të infrastrukturës duke u mbështetur në teknikat dhe zgjidhjet bashkëkohore.

Me respekt,

*Bajram IBRAJ
Kryetar*

1. 1 AKTIVITETI VJETOR



Komiteti i AAB-së për Sigurinë Bankare (KSB) zhvilloi tetë mbledhje gjatë vitit 2010, në të cilat anëtarët e Komitetit shkëmbyen informacione për ngjarje dhe eksperiencë mbi çështje të sigurisë në bankat përkatëse.

Në shkurt të vitit 2010 anëtarët e KSB-së zgjedhën Kryetarin e ri Z. Bajram IBRAJ nga Intesa SanPaolo Bank, dhe dy Zëvendës Kryetarët Z. Sokrat DYLGJERI nga Raiffeisen Bank dhe Z. Qirjako TAÇE nga Union Bank.

Gjatë periudhës Mars-Qershor 2010, ky Komitet pati disa mbledhje të të gjithë anëtarëve, por edhe vetëm të Kryesisë, lidhur me ndryshimet e Rregullores Nr. 91 "Për kriteret minimale të sigurisë së ambienteve në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare".

Në mbledhjet e Komitetit gjatë Prillit dhe Qershorit u paraqitën disa prezantime nga anëtarët dhe nga pjesëmarrës të jashtëm, lidhur me grabitjet në banka dhe institucione financiare në Shqipëri gjatë viteve të fundit, funksionet e sistemeve të sigurisë së bankave, organizimi i mbrojtjes nga zjarri dhe emergjencat në bankë, etj..

Një nga çështjet e trajtuara në mbledhjet e KSB-së ka qenë transportimi i vlerave monetare ndërmjet bankave dhe Bankës së Shqipërisë, proces i cili u vështirësua me zhvendosjen e BSh-së në ndërtesë të re. Për këtë, Sekretariati i AAB-së i dërgoi një shkresë Departamentit të Sigurisë dhe Mbrojtjes së BSh-së, për lehtësimin e procedurave dhe formave të autorizimit të transportit të vlerave monetare. Kërkesa pati një përgjigje pozitive dhe konstruktive nga BSh.

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2010, anëtarët e KSB-së kanë pasur komunikim të vazhdueshëm mbi ngjarje vjedhjesh e grabitjesh në banka të veçanta. Nisur nga këto ngjarje, anëtarët e Komitetit kanë shkëmbyer informacion por edhe kanë diskutuar mbi mënyrat e parandalimit të tyre dhe rritjen e sigurisë në ambientet e bankave. Në mbledhjen e mbajtur në Nëntor 2010, përfaqësuesit e Intesa SanPaolo Bank bënë një prezantim mbi Sigurinë e Informacionit dhe lidhjen e fortë të kësaj të fundit me sigurinë fizike në banka.

II. AKTIVITETI I KOMITETEVE TË AAB-SË

2. KOMITETI I AAB-SË PËR LUFTËN KUNDËR MASHTRIMIT ME KARTAT



Zj. Enkelejda Balliu
Asistente e Zv. Presidentit
Përgjegjëse e Zyrës së
Parandalimit dhe Monitorimit të
Mashtrimeve
Intesa Sanpaolo Bank, Shqipëri

I dashur Lexues,

Biznesi i kartave elektronike si mjet pagese erdhi si risi në tregun shqiptar dhe pati hov të konsiderueshëm në gjithë drejtimet. Sot kemi një treg të konsoliduar me larmishmëri produktesh dhe mundësi rritje të padiskutueshme. Por, rritja e këtij biznesi shoqërohet me rritjen e risqeve që e shoqërojnë. Në një ambient global e kompleks, grupet kriminale gjithnjë e më të sofistikuar synojnë hallkën më të dobët të zinxhirit: vendet në zhvillim në këtë drejtim, me paqëndrueshmëri politike e varfëri. Gjithashtu, rritja e masave të sigurisë nëpërmjet zhvillimit të teknologjive CHIP e PIN në vende me potencial të madh mashtrimi, zhvendos veprimtaritë e grupeve kriminale në vendet/bankat e reja në sistemet e pagesave me karta dhe pa eksperiencë.

Ishte iniciativë dhe propozim i Visa International në vitet 2005-2006, krijimi i forumit të përbashkët të bankave me qëllim parandalimin e mashtrimeve nëpërmjet bashkëpunimit mes bankave, autoriteteve të ligjit dhe institucione të tjera. Që në mbledhjet e para, tryezës së ekspertëve të kartave nga bankat, iu bashkuan kolegët e Policisë, Prokurorisë dhe më vonë kolegë nga zyra e OPDAT pranë Ambasadës Amerikane në Tiranë.

Falë mbështetjes së AAB-së dhe me vendimin të Bordit Drejtues në Prill 2007, ky Forum u organizua si komitet i përhershëm teknik nën ombrellën e AAB-së, i quajtur Komiteti i AAB-së për Luftën Kundër Mashtrimeve me Karta. Ky Komitet, tashmë më i organizuar, efikas, operacional dhe fleksibël, me reputacion më të konsoliduar, vazhdon aktivitetin e tij me dëshirën për të arritur rezultate konkrete në parandalimin e mashtrimeve.

Viti 2010 shënoi kulmin e bashkëpunimit të arritur ndonjëherë mes bankave dhe autoriteteve të ligjit, Njësisë së Krimit Ekonomik në Policinë e Tiranës dhe Task Forcës së Krimit Ekonomik në Prokurorinë e Tiranës. Falë një punë të mirë koordinuar të grupit të krijuar nga Komiteti ynë, u bë i mundur zbulimi, administrimi i provave dhe arrestimi i personave përgjegjës për një skemë mashtrimi në POS-et e vendosura në tregtarë të ndryshëm, sidomos në qendrat tregtare.

Do të falënderoja veçanërisht kolegët e miq të Komitetit për mbështetjen dhe kontributin e tyre të paçmueshëm në ngritjen dhe zhvillimin e biznesit të kartave në Shqipëri, zbulimin dhe parandalimin e shumë rasteve mashtrimi dhe zhvillimin e plot aktiviteteve të tjera.

Përpjekjet tona për vitin në vijim do të fokusohen kryesisht në:

1. krijimin e procedurave të përbashkëta me Policinë për raportimin e rasteve të dyshimta;
2. ngritjen e task force për standardet e sigurisë për ruajtjen dhe transmetimin e të dhënave për "PCI DSS COMPLIANCE";
3. krijimin e një baze të dhënash për shkëmbimin e sigurt të informacionit mes bankave në rastet e mashtrimeve me karta;
4. trajnime të përbashkëta me partnerët tanë Visa e Mastercard, dhe OPDAT;

Vetëm bashkëpunimi me strategji të qarta dhe zhvillimi i teknikave për shkëmbimin e informacionit është çelësi i suksesit dhe ruajtjes së reputacionit të biznesit dhe për më shumë ruajtjes së reputacionit të vendit tonë.

Sinqerisht,

Enkelejda BALLIU

Kryetare

2.1 AKTIVITETI VJETOR



Komiteti i Luftës Kundër Mashtrimeve me Karta (LKMK) zhvilloi katër mbledhje gjatë vitit 2010, tre nga të cilat me prezencën e përfaqësuesve nga VISA; zyra OPDAT, Departamenti i Drejtësisë së SHBA-ve; dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, të cilët janë aktorë shumë të rëndësishëm në luftën kundër mashtrimeve.

Përfaqësuesit nga VISA dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë bënë prezantime mbi tendencat e Mashtrimeve në Shqipëri dhe rajon, dhe mjetet për parandalimin e hetimin e mashtrimeve me karta, si zyra e re e luftës kundër krimit elektronik në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.

Gjatë gjysmës së dytë të vitit LKMK përfundoi me sukses procesin e përputhjes me standardin PCI DSS për tregtarët në Shqipëri. Për këtë qëllim u krijua një grup pune me përfaqësues të 6 bankave (anëtar te përhershëm te LKMK): Raiffeisen Bank, Intesa Sanpaolo Bank, Banka Kombëtare Tregtare, Tirana Bank, Banka Procedit dhe Alpha Bank, të cilët krijuan listën e 83 tregtarëve të përbashkët që u bënë pjesë e procesit për vlerësimin e përputhshmërisë me kërkesat e PCI DSS sipas kategorive të tregtarëve. U krijua edhe një grup "task force" me pjesëmarrjen e gjithë bankave për inspektimin dhe certifikimin PCI DSS në vendin e ushtrimit të aktivitetit tregtar. Nga këto inspektime rezultoi se vetëm një nga tregtarët (një Agjenci udhëtimesh) përdorte një program për të ruajtur të dhëna të mbajtësit të kartës, rast që u dërgua për verifikim dhe vlerësim. Të gjithë tregtarët e inspektuar nënshkruan pyetësorët duke plotësuar kështu fazën e fundit të përputhjes me standardin PCI DSS.

Në mbledhjen e fundit të vitit anëtarët e Komitetit diskutuan për rëndësinë e organizimit të trajnimeve dhe forumeve lidhur me informacionin që duhet të shkëmbehet ndërmjet bankave dhe forcave të policisë e prokurorëve. Për këtë qëllim, Sekretariati i AAB-së planifikoi për vitin 2011 organizimin e një forumi mbi mashtrimet, me përfaqësues nga bankat, Policia, Prokuroria, VISA e Master Card, dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm.

II. AKTIVITETI I KOMITETEVE TË AAB-SË

3. KOMITETI I AAB-SË PËR PËRPUTHSHMËRINË



Z. Ndue Maluta
Zëvendës Drejtor i Grupit të
Manaxhimit të Riskut dhe Officer
Përputhshmërie në Bankën
Kombëtare Tregtare

I dashur Lexues,

Sistemi Bankar Shqiptar po bëhet gjithmonë e më shumë një sistem referimi për të gjithë komponentët e zhvillimit të shoqërisë shqiptare, përfshirë ato ekonomike, sociale apo legjislative. Si i tillë, krahas rritjes së biznesit të vet, atij i duhet të jetë gjithmonë e më shumë i përshtatur e reflektiv në lidhje me çdo detyrim të ri që bashkëjetesa me këto komponentë i përcakton.

Është për këtë arsye që roli i punonjësve të përputhshmërisë në çdo bankë po bëhet jo vetëm më i rëndësishëm, por edhe më i vështirë e kompleks. Tashmë jo vetëm bankat e mëdha në Shqipëri por edhe ato të mesme dhe të vogla kanë krijuar në strukturat e tyre Departamentin e Përputhshmërisë duke i dhënë një rëndësi të veçantë jo vetëm rolit të parandalimit të pastrimit të parave si një pjesë përbërëse e kësaj strukture por edhe kryerjes së aktivitetit të tyre në përputhje të plotë me ligjet dhe standardet kombëtare e ndërkombëtare.

Mbi këtë vlerësim, lindi natyrshëm nevoja e krijimit të Komitetit të Përputhshmërisë si një strukturë përbërëse e AAB-së, roli i të cilit do të jetë përmirësimi i efikasitetit në kryerjen e këtij funksioni nga ana e bankave. Komiteti, i përbërë nga punonjësit e përputhshmërisë së çdo banke anëtare të AAB-së, ka filluar jetën e vet më datë 1 Mars 2010 sipas vendimit të Bordit Drejtues të AAB-së. Në mbledhjen e vet të parë, ky komitet zgjodhi Kryesinë e përbërë nga tre anëtarë. Natyrisht që për mua ishte një vlerësim por edhe përgjegjësi zgjedhja si Kryetar i këtij Komiteti, dhe me këtë rast nuk mund të rri pa falënderuar të gjithë anëtarët për mbështetjen dhe në veçanti anëtarët e Kryesisë Zj. Mirela Bërdufi nga Banka Emporiki dhe Z. Agim Saqe nga NBG.

Dy ishin iniciativat më të rëndësishme të ndërmarra prej këtij Komiteti gjatë vitit 2010.

E para kishte të bënte me ndërhyrjen për rregullimin e komunikimit formal në përputhje me Ligjin midis Autoriteteve Tatimore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave nga njëra anë dhe bankave nga ana tjetër. Kjo ndërhyrje gjeti mirëkuptimin e palëve dhe ka filluar të japë rezultate të mira në efikasitetin e përmbushjes së detyrimeve ligjore që bankat kanë kundrejt këtyre autoriteteve.

Iniciativa e dytë lidhet me synimin për të rregulluar aksesimin e bankave në informacionin mbi pozicionin penal të klientëve të tyre. Përpjekjet për përmbushjen e këtij synimi do të jenë pjesë e aktivitetit në vazhdim të këtij Komiteti.

Detyra thelbësore e këtij Komiteti do të jetë përvijimi i urave të një komunikimi konstruktiv midis bankave dhe autoriteteve shtetërore, si dhe mbajtja gjallë e një tryeze konsultimi të vazhdueshëm midis tyre

Urojmë që iniciativa të ngjashme për bashkërendimin e përpjekjeve tona për një sistem bankar të shëndetshëm dhe efikas të rezultojnë të suksesshme edhe në të ardhmen.

Me respekt,

Ndue MALUTA

*Ish Kryetar
& Zëvendës Kryetar aktual*

3. 1 AKTIVITETI VJETOR



Në shkurt 2010, Sekretariati i AAB-së organizoi një takim me oficerë të Përputhshmërisë të bankave anëtare, për të diskutuar mbi kërkesat e vazhdueshme për informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), dhe Zyrat e Tatimeve. Shqetësimet e ngritura iu adresuan autoriteteve përkatëse me shkresa zyrtare nga AAB. Në vijim, Sekretariati i AAB-së propozoi ngritjen e një Komiteti teknik për Përputhshmërinë nën ombrellën e AAB-së, me qëllim përputhshmërinë e tyre me kuadrin rregullator. Komitetit Ekzekutiv i AAB-së, në mbledhjen e tij të datës 1 Mars 2010, miratoi krijimin e Komitetit të AAB-së për Përputhshmërisë (KP).

KP zhvilloi mbledhjen e parë në Prill të vitit 2010, ku anëtarët zgjodhën kryesinë e Komitetit me Kryetar Z. Ndue Maluta - Banka Kombëtare Tregtare, dhe Zëvendës Kryetarë Zj. Mirela Bërdufi - Emporiki Bank, dhe Z. Agim Saqe - Banka Kombëtare e Greqisë. Gjatë vitit 2010 KP zhvilloi edhe katër mbledhje të tjera.

Në Prill 2010 anëtarët e KP-së diskutuan nevojën e bankave për të marrë informacion "online" nga Ministria e Drejtësisë mbi gjendjen penale të klientëve të tyre. Për këtë arsye Sekretariati i AAB i kërkoi me një shkresë Ministrisë së Drejtësisë përfshirjen e bankave në listën e institucioneve që kanë akses në databazën elektronike.

Një tjetër çështje e rëndësishme ishte ajo lidhur me urdhrat e parregullta dhe joprofessionale për bllokimin e llogarive që u dërgoheshin bankave nga Drejtoritë Rajonale Tatimore të disa qyteteve. Me vendim të KP-së, AAB u dërgoi një shkresë të gjitha Drejtorive Rajonale Tatimore, për dijeni Bankës së Shqipërisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me kërkesën që urdhrat e bllokimit të ndjekin procedurat dhe formatet e përcaktuara në Ligjet dhe Rregulloret përkatëse. Ky veprim pati efektin e prituri pasi u përmirësua ndjeshëm komunikimi me institucionet e sipërpërmendura.

Ndër gjithë çështjet e diskutuara në mbledhjet e KP-së, shqetësimet kryesore kanë qenë lidhur me luftën kundër pastrimit të parave, veçanërisht me raportimin e bankave tek DPPPP, lidhur me kohën, kompleksitetin e raportimeve, bazës ligjore të kërkesave nga Autoriteti, dhe pamundësisë së bankave për të plotësuar disa prej tyre. Në lidhje me këto çështje, Sekretariati i AAB-së organizoi një takim të Kryesisë së KP-së me përfaqësues të DPPPP-së dhe Bankës së Shqipërisë në Dhjetor 2010. Takimi ishte i suksesshëm në vendosjen e bazave për një komunikim më efektiv, dhe ofrimin e një mundësie të mirë përfaqësuesve të KP-së për t'u përcjellë shqetësimet e tyre autoriteteve.

II. AKTIVITETI I KOMITETEVE TË AAB-SË

4. KOMITETI LIGJOR I AAB-SË



Av. Veronika Prifti
Përgjegjëse e Departamentit të
Çështjeve Ligjore
Banka Kombëtare Tregtare

I dashur Lexues,

Kanë kaluar shumë vite nga krijimi i AAB-së dhe sot me vijnë ndër mend përpjekjet e hershme për krijimin e një shoqatë të tillë. Sot, në dritën e këtyre viteve eksperiencë, mund të themi fortësisht se AAB është bërë faktor evident dhe aktiv i Sistemit Bankar Shqiptar, duke sjellë pozitivitet dhe frytshmëri në punën e Sistemit.

I krijuar që në vitet e para të jetës së Shoqatës, Komiteti Ligjor i AAB-së, u konceptua fillimisht si strukturë konsultative e Bordit Drejtues dhe Asamblesë së Anëtarëve, por u konsolidua më pas si një tryezë e përhershme eksperiencë dhe debati profesional për juristët e Bankave anëtare.

Ndryshimet e legjisllacionit në vend dhe veçanërisht përshtatja e tij me vendet e BE-së, kanë pasur në çdo moment vëmendjen e Komitetit Ligjor të AAB-së, si një faktor bashkëpunues, por disa herë edhe oponent, në lidhje me iniciativa të caktuara legjisllative, veçanërisht ato që ndikojnë drejtpërdrejtë veprimtarinë bankare. Mjaft i rëndësishëm ishte ndikimi i Komitetit Ligjor të AAB-së në ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile, veçanërisht për ekzekutimet e detyrueshme, apo edhe në ndryshimet e vazhdueshme në legjisllacionin fiskal dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Qëllimi kryesor i Komitetit ka qenë dhe mbetet krijimi i një ambienti të përshtatshëm rregullator që lejon bankat të ushtrojnë veprimtari bankare të guximshme dhe bashkëkohore, por gjithnjë brenda normave të ligjshmërisë dhe konkurrencës së ndershme. Komiteti, është bërë shpesh promotor i tryezave të përbashkëta mes bankave, grupeve të biznesit dhe autoriteteve publike, nga ku kanë dalë zgjidhje të favorshme apo janë mundësuar zbatime të logjikshme dhe unifikuar praktike. E tillë ka qenë gjatë vitit 2010 përpjekja për unifikim në praktikat e urdhrave të organeve tatimore, qendrore apo lokale, për bllokimin e llogarive bankare të tatimpaguesve debitorë, si dhe insistimi për t'i dhënë fund praktikave jo korrekte apo mbi ligjin të ndonjë strukture të administratës publike.

Aktualisht, Komiteti Ligjor është angazhuar maksimalisht në zgjidhjen e problematikave me pasuritë e paluajtshme, që nga ndryshimet e nevojshme në legjisllacion, ndryshimin e mentaliteteve të gabuara në zbatimin e ligjit material, ndërprerjen e veprimeve të pakujdesshme nga administrata e regjistrimit të pasurive të paluajtshme etj. Komiteti synon që Sistemi Bankar të jetë pjesë e zgjidhjeve ligjore dhe praktike që do t'i jepen problemit të pasurive të paluajtshme në Shqipëri, dhe veçanërisht ekzekutimit të tyre të detyrueshëm.

Në fokusin e punës së Komitetit, do të jetë gjetja e zgjidhjeve ligjore dhe unifikuese për praktikat gjyqësore lidhur me procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke lobuar për këto zgjidhje si pranë administratës së sistemit të drejtësisë, por veçanërisht pranë sistemit gjyqësor dhe strukturave drejtuese e mbikëqyrëse të tij.

Unë falënderoj të gjithë kolegët që kanë qenë pjesë aktive e Komitetit Ligjor dhe uroj që puna jonë të jetë akoma më e frytshme në konsolidimin dhe ecjen përpara të Sistemit Bankar Shqiptar.

Miqësisht,

*Veronika Prifti
Kryetare*

4. 1 AKTIVITETI VJETOR



Komiteti Ligjor i AAB-së (KL) pati tre takime gjatë vitit, që u përqendruan kryesisht në çështjet ligjore dhe interpretimin e tyre lidhur me aktivitetet e bankave.

Në takimin e parë në Mars 2010, anëtarët e KL-së diskutuan dhe hartuan komentet dhe opinionet e kërkuara nga Ministria e Financave mbi projektligjin “Për shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”. Takimi u pasua nga komunikimet dhe kontributet me shkrim të anëtarëve të KL-së.

Çështja kryesore e diskutimit në mbledhjen e Komitetit në Tetor 2010 ishte ajo lidhur me interpretimet ligjore mbi urdhrat e ndryshme të bllokimit që vijnë për bankat nga autoritete të ndryshme, dhe juristët e bankave shkëmbyen përvojat në bankat përkatëse me këto urdhra. Anëtarët e Komitetit diskutuan mbi numrin e madh të kërkesave të tilla nga autoritetet e ndryshme si Njësitë Bashkiake, Zyrat Rajonale Tatimore, etj.; format e tyre të ndryshme; dhe pamundësinë e plotësimit të afateve të tyre. Ata gjithashtu ranë dakord për disa ndryshime që duhen bërë në Udhëzimin “Për Procedurat Tatimore”, me qëllim për të lehtësuar ekzekutimin e këtyre urdhrave bllokimi.

Të gjitha sugjerimet dhe komentet e mësipërme u dërguan për Këshillin Konsultativ të Biznesit, në përgjigje të kërkesës së tyre për opinione mbi draft propozimin për disa ndryshime në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Takimi i fundit i KL-së për vitin 2010 (në Dhjetor) u përqendrua në një projekt udhëzues të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë e Tiranës, të dërguara dhe diskutuara individualisht nga ata me disa nga bankat anëtare. Ky projekt udhëzues synon krijimin e procedurave të ekzekutimit të urdhrave të bllokimit të Bashkisë së Tiranës. Pas diskutimit të tij në detaje, Komiteti Ligjor i AAB-së vendosi që Sekretariati i AAB-së duhet t'i drejtohej Drejtorisë së mësipërme me një kërkesë për një takim, ku anëtarët e LK-së mund të paraqisnin të gjitha shqetësimet e tyre në lidhje me këtë projekt. Përgjigja ishte pozitive dhe një takim i tillë u mbajt më 12 Janar 2011.

II. AKTIVITETI I KOMITETEVE TË AAB-SË

5. KOMITETI I AAB-SË PËR SISTEMET E PAGESAVE



Në fund të Shtatorit 2010, Komiteti i AAB-së për Sistemet e Pagesave (KSP) u riaktivizua dhe u mbledh në ambientet e AAB-së, për të diskutuar për çështjen e burokracive të tepërta lidhur me përdorimin e Çeqeve bankare, të cilat përdoren shumë rrallë mes bankave, si edhe mbi çështje të tjera që lidhen me sistemet e pagesave.

Në këtë kontekst, me vendim të Komitetit, Sekretariati i AAB-së u shpërndau anëtarëve kopje elektronike të akteve ligjore përkatëse, vënë në dispozicion nga Banka e Shqipërisë, për mbledhjen e opinioneve të tyre për përgatitjen e një propozimi për ndryshime mundshme të atyre akteve që lidhen me Çequet, por edhe në lidhje me çështje të tjera që duhet të përditësohen me sistemet aktuale të pagesave.

Një tjetër çështje e diskutuar në takim ishte edhe ai i seksioneve të clearing-ut të pagesave në sistemin e pagesave të Bankës së Shqipërisë (kufizuar në dy seksione gjatë ditës). Komiteti propozoi futjen e një seance të tretë për një organizim më të mirë të punës në banka në lidhje me transaksionet e pagesave.

Gjithashtu, anëtarët e KSP-së diskutuan në lidhje me komisionet e aplikuara nga Banka e Shqipërisë për përdorimin e sistemeve AECH dhe AIPS, duke theksuar se tarifat fikse për transaksionet në AIPS janë mjaft të larta, ndërsa këto transaksione janë të paktë në numër, ndaj kosto për transaksion përmes AIPS rezultaton e lartë dhe klientëve të bankave u ngarkohen tarifa më të larta. Në këtë drejtim, anëtarët e Komitetit propozuan t'i kërkohej Bankës së Shqipërisë rritja e vlerës limit për transaksionet në AIPS.

Sekretariati i AAB-së ia përcolli këto propozime Bankës së Shqipërisë, e cila në fund të Dhjetor informoi të gjitha bankat mbi vendimin e saj që të ketë tre seanca për clearing-un e pagesave gjatë ditës së punës, dhe për rritjen e vlerës së pagesave nëpërmjet AIPS nga 1.000.000 Lekë në 1.500.000 Lekë.

6. KRIJOHET KOMITETI I AAB-SË PËR SIGURINË E INFORMACIONIT



Sekretariati i AAB-së ishte informuar gjatë vitit të fundit mbi disa çështje të Sigurisë së Informacionit në banka, të ngritura nga punonjës përgjegjës për sigurinë e informacionit në bankat anëtare. Këto lidhen me sigurinë e shërbimeve online (internet banking, email, etj.), masat që duhen ndërmarrë nga bankat në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale (politikat e sigurisë së informacionit, trajnime, etj.) si dhe çështjet tjera relevante. Duke marrë në konsideratë të gjitha më lart, Sekretariati i AAB-së organizoi një takim me punonjësit përgjegjës për sigurinë e informacionit në bankat anëtare, më 1 Dhjetor 2010.

Pas diskutimeve në këtë takim, Sekretariati i AAB-së propozoi krijimin e një Komiteti të ri teknik të përhershëm, nën ombrellën e AAB-së, përkatësisht Komiteti i AAB-së për Sigurinë e Informacionit. Bordi Drejtues miratoi këtë propozim AAB në mbledhjen e tij në 6 Dhjetor 2010.

Qëllimi i këtij Komiteti do të jetë të punojë për çështjet dhe shqetësimet e bankave anëtare në lidhje me rritjen dhe përmirësimin e sigurisë së informacionit në banka. Aktivitetet e tij do të fokusohet mbi monitorimin dhe sigurimin i informacionit për kuadrin rregullator në lidhje me Sigurinë e informacionit në veprimtarinë e bankave dhe ndryshimet në të, si edhe mundësimin e shkëmbimit të eksperiencave mbi tendencat e fundit në sigurinë e informacionit, me qëllim zbatimin e standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira në lidhje me masat e marra në këtë fushë. Të gjitha bankat anëtare do të kenë një vend në Komitet, për personat e caktuar nga Drejtuesit përkatëse.



Porta e murit të jashtëm të kalasë së Petrelës, seli e motrës së Skënderbeut, Mamicës. Gjysma I e shek. XV.

III. AKTIVITETET OPERACIONALE TË AAB-SË



1. SEMINARE DHE TRYEZA TË RRUMBULLAKËTA

• Seminar mbi Vlerësimin e Impaktit Rregullator

Në Janar 2010, AAB dhe SPI organizuan një seminar mbi Vlerësimin e Impaktit Rregullator, mbajtur nga një nga ekspertët më të mirë të kësaj fushe, Z. Qamar Zaman, i ardhur nga FSA në MB. Seminari, me pjesëmarrës nga bankat anëtare të AAB-së dhe Banka e Shqipërisë, ishte një bashkëbisedim ndërinstitucional me qëllim informimin mbi teknikat e përdorura në shtetet e BE-së për të prodhuar një kuadër rregullator të cilësisë së lartë.

Reagimet e marra nga pjesëmarrësit në seminar treguan një interes të fortë nga Banka e Shqipërisë dhe bankat mbi metodologjinë RIA.

• Tryezë e Rrumbullakët mbi Huamarrjen e Qeverisë Lokale

AAB ka bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme me Programin e Qeverisjes Lokale të USAID në Shqipëri (LGPA), që punon me bashkitë në të gjithë Shqipërinë dhe ka bërë të mundur krijimin e kredive bankare për bashkitë, si pjesë e asistencës teknike për zhvillimin ekonomik lokal dhe mbështetjen e hartimit të ligjit për huamarrjen lokale. Për përmirësimin dhe thjeshtimin e procesit të huadhënies për bashkitë nëpërmjet hartimit të dokumenteve model, AAB dhe LGPA organizuan dy tryeza të rrumbullakëta në ambientet e AAB-së me pjesëmarrje nga bankat anëtare.

Në tryezën e parë, në Shkurt 2010, përfaqësues nga bankat, kryesisht ekspertë të administrimit të kredive dhe/ose të marrëdhënieve me institucionet publike, diskutuan mbi dokumentet e nevojshme në procesin e huadhënies si marrëveshjet e kontratave të kredive; marrëdhëniet me thesarin; raportimet etj., si dhe mbi çështje të tjera lidhur me procesin e huadhënies për bashkitë.

Tryeza e dytë e rrumbullakët me juristë të bankave u organizua në Maj 2010 dhe pjesëmarrësit diskutuan e komentuan mbi draftet model për Marrëveshjet e Interceptimit dhe Kontratat e Huave midis njësive lokale dhe bankave, të përgatitura më parë nga LGPA.

• Konferenca me Universitetin Evropian të Tiranës

AAB dhe Instituti i Inxhinierisë mbështetën Universitetin Evropian të Tiranës në organizimin më 30 Prill 2010 të një Konference mbi “Përballjen e Tregut Financiar Shqiptar me Krizën Ekonomike Globale”, në ambientet e UET-së. Gjatë kësaj Konference u prezantuan dhe u diskutuan me pjesëmarrësit materiale të ndryshme të përgatitura nga profesorë dhe ekspertë financiarë, përgjithësisht të fokusuar mbi krizën financiare dhe sfidat aktuale që përballen nga tregu financiar Shqiptar.

• Seminari i Bloomberg-ut

Bloomberg zhvilloi një seminar gjysmë-ditor në ambientet e AAB-së në Maj 2010, për prezantimin e këtij sistemi dhe karakteristikave të tij në FX, Tregti Elektronike FX, Treg Monetar e të Ardhura Fikse. Seminari ishte në interes të personave përgjegjës në departamentet e thesarit dhe operacioneve të thesarit të bankave anëtare dhe pjesëmarrësve të tjerë.

• Seminar i IOM për Dërgesat e Emigrantëve në Shqipëri

Organizata Ndërkombëtare për Migracionin në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave organizoi një seminar me temë “Dërgesat në Shqipëri: Sfidat dhe arritjet e sektorit Bankar Shqiptar”, me pjesëmarrjen e rëndësishme të përfaqësuesve nga bankat anëtare dhe Z. Gazmend Kadriu, që përfaqësoi AAB-në si Kryetar i saj.

Seminari kishte për qëllim shkëmbimin e eksperiencave në kanalizimin e dërgesave në Shqipëri përmes sektorit formal dhe mundësimin e një debati mbi mënyrat se si produktet dhe shërbimet bankare mund t’u përshtaten më mirë nevojave të emigrantëve. Për këtë arsye, pjesëmarrës në seminar ishin shumë palë të interesuara si agjencitë qeveritare, agjencitë e zhvillimit lokal që veprojnë në tregun financiar në Shqipëri dhe organizata ndërkombëtare.

2. PUBLIKIMET

Sekretariati i AAB-së përgatiti Raportin Vjetor AAB 2009 (si publikim dy gjuhësh) që u publikua dhe u shpërnda brenda Korrikut 2010. Raporti përfshin të dhënat financiare të AAB-së për vitin 2009 të cilat u audituan nga Societe Generale Albania dhe u raportuan respektivisht tek autoritetet Tatimore. Të dy versionet Anglisht dhe Shqip janë vendosur në faqen e internetit të AAB-së.

Sekretariati i AAB-së vazhdoi të publikonte Buletinin Tremujor të AAB-së, për periudhën e tremujorit të fundit 2009 dhe tremujorin e parë dhe të dytë 2010.

Sekretariati i AAB-së gjithashtu ka azhurnuar e mirëmbajtur faqen e internetit duke publikuar të dhëna tremujore të mbledhura nga bankat anëtare dhe të dhëna mujore të marra nga Banka e Shqipërisë.



3. PJESEMARRJET

• Konferenca për Financa të Përgjegjshme

Fondi Evropian për Evropën Jug-Lindore (EFSE) organizoi një konferencë gjysmë-ditore në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe KFW në Mars 2010. Eventi siguroi një debat ekspertësh me qëllim rritjen e vëmendjes ndaj Financave të Përgjegjshme ndërmjet palëve te sektorit financiar dhe publikut të gjerë në Shqipëri. Z. Catalano që përfaqësonte AAB-në si Kryetari i saj mbajti një prezantim mbi shqyrtimin e kësaj teme nga pikëpamja e AAB-së.



• Forumi i Katërt i Hapur me Sistemin Bankar

Banka e Shqipërisë organizoi gjatë Prillit 2010 Forumin e Katërt të Hapur me Sistemin Bankar. Forumi ekzaminoi çështjet e stabilitetit financiar te sistemit lidhur me zhvillimet e fundit si në vend ashtu edhe jashtë tij. Për këtë qëllim Banka e Shqipërisë ndau me bankat e tjera konsideratën dhe pikëpamjet e saj lidhur me objektivat e caktuara në forumin e fundit, dhe situatën aktuale e riskun potencial në të ardhmen duke diskutuar rreth analizave, konkluzioneve, arritjeve dhe masave për tu ndërmarrë nga Grupet Bankare dhe nga Bankat individuale me qëllim menaxhimin e sfidave aktuale.

• Mbledhja e 11-të e IFBA-së në Athinë

AAB u përfaqësua nga Sekretarja e Përgjithshme në mbledhjen e 11-të të Forumit INTERBALLKANIK të Shoqatave të Bankave, në Athinë, Greqi në Qershor 2010.

• Forumi i BSh-së mbi Tregun Ndërbankar

Sekretariati i AAB-së dhe Drejtuesit e përfaqësues të tjerë të Bankave Anëtare, morën pjesë në Qershor 2010 në Forumin e organizuar nga Banka e Shqipërisë titulluar “Zhvillimi i tregut ndërbankar dhe përmirësimi i politikës operacionale në Bankën e Shqipërisë”. Në fokus të këtij forumi ishte diskutimi mbi hapat e nevojshëm për zhvillimin e mëtejshëm të tregut ndërbankar në Shqipëri.

• Këshilli Tatimor

Ministria e Financave krijoi Këshillin Tatimor si një forum teknik konsultativ dhe bashkëpunimi mes Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe taksapaguesve. Pas aprovimit nga Bordit Drejtues, AAB aplikoi dhe u anëtarësua në këtë Këshill, përfaqësuar nga Sekretarja e Përgjithshme, duke e konsideruar atë si një mundësi të mirë lobimi për çështjet e taksave, megjithëse aktiviteti kryesor i Këshillit do jetë i një natyre konsultative. Këshilli Tatimor pati takimin e tij të parë në Nëntor 2010.

• Takimi i 31-të i Anëtarëve të Asociuar të EBF-së në Bruksel

Sekretarja e Përgjithshme përfaqësoi AAB-në takimin e 31-të të Anëtarëve të Asociuar të EBF-së, që u mbajt në Bruksel, në Dhjetor 2010. Znj. Xhaferaj dha një prezantim të zhvillimeve më të fundit ekonomike në Shqipëri, duke u fokusuar veçanërisht në zhvillimet në sektorin bankar shqiptar.

• Tryezë e Rrumbullakët e Organizuar nga CIPE

Sekretariati i AAB-së u përfaqësua nga Specialistja e Operacioneve në tryezën e rrumbullakët "Sfidat dhe mundësitë/stimujt në kontekst të krizës ekonomike globale" në Dhjetor - e para nga seria e tre tryezave të rrumbullakëta të organizuara nga Qendra për Ndërmarrjet Private Ndërkombëtare (CIPE) në bashkëpunim me partnerin lokal të CIPE-s, Qendra Shqiptare për Kërkimet Ekonomike (ACER).

• Këshilli Konsultativ i Biznesit

AAB u përfaqësua nga Sekretarja e Përgjithshme si anëtare me të drejta të plota në dy mbledhjet e Këshillit Konsultativ të Biznesit, në Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, në Korrik dhe Tetor 2010. Në të dy mbledhjet Sekretarja e Përgjithshme përcolli opinionet dhe komentet e të gjithë Bankave anëtare të AAB-së lidhur me çështjet për diskutim.

• Mbledhje Bordi të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore

AAB mori pjesë, nëpërmjet Sekretares së Përgjithshme si anëtare, në mbledhjen e Bordit Drejtues të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore (MADA), në Dhjetor 2010. Sekretarja e Përgjithshme e AAB-së u zgjodh Kryetare e Komitetit Mbikëqyrës të Skemave të Garancisë së Kredive, një projekt i ri i MADA-s për të mbështetur tregun rural duke u ofruar stimuj bankave dhe institucioneve të tjera financiare për të kredituar fermerët e këtyre zonave.

4. EVENTE SHOQËRORE

• Evente Lamtumire dhe Mirëseardhjeje

Sekretariati i AAB-së organizoi një pritje Mirëseardhjeje / Lamtumire në Maj të vitit 2010, me rastin e zgjedhjes të Z. Gazmend Kadriu si Kryetari i ri i AAB-së pas dorëheqjes së Z. Libero Catalano, si edhe me rastin e largimit të Z. Borislav Kostandinov nga Shqipëria dhe nga pozicioni i Drejtorit Ekzekutiv të ProCredit Bank-Albania.

Një pritje tjetër lamtumire u organizua nga AAB në fund të Shtatorit 2010, me rastin e largimit të Z. Oliver Whittle nga pozicioni i Drejtorit Ekzekutiv të Raiffeisen Bank, dhe gjithashtu nga pozicioni i tij si Zëvendës Kryetar i Bordit Drejtues të AAB-së.



- **Donacioni për familjet e përmbytura në veri të Shqipërisë**

Duke marrë parasysh situatën e jashtëzakonshme për shkak të përmbytjeve të mëdha të cilat goditën veriun e Shqipërisë gjatë muajve Nëntor dhe Dhjetor 2010, me propozim të Bordit Drejtues të AAB-së dhe miratimin e të gjithë Drejtuesve të bankave anëtare, AAB kontribuoi për të mbështetur familjet e prekura nga kjo gjendje emergjence, duke dhuruar 6,000,000 lekë.

















- **Darka e AAB-së për festat e fundvitit**

Më 16 Dhjetor 2010, AAB organizoi një darkë festive me rastin e festave të fundvitit. Në këtë event morën pjesë Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Drejtuesit dhe Menaxherët e Përgjithshëm të bankave anëtare, si edhe të ftuar të tjerë special nga Banka e Shqipërisë.


















IV. BANKAT ANËTARE

TË DHËNA TË AUDITUARA SIPAS SNRF-VE (PËR UBA SIPAS STANDARDEVE TË BSH-SË) MË 31.12.2010

BANKAT	NË SHQIPËRI QË NË VITIN:	STRUKTURA E AKSIONERËVE:	SHTETI I ORIGJINËS
 ALPHA BANK	1998	Alpha Bank - 100%	Greqi
 United Bank of Albania Banka e Bashkuar e Shqipërisë	1993	Islamic Development Bank - 55% Shamil Bank Of Bahrain (E.C.) - 20% Të tjerë - 25.51%	Ndërkombëtar Arabia Saudite Arabia Saudite
 NBG Bank	1996	National Bank of Greece S.A. – 100%	Greqi
 BKT BANKA KOMBETARE TREGTARE	1993	Çalik Finansal Hizmetler A.S. -100%	Turqi
 CBA CREDIT BANK OF ALBANIA BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISE	2003	Al-Kharafi Group – 100%	Kuvajti
 Banka Ndërkombetare Tregtare International Commercial Bank	1996	ICB Financial Group - 100%	Malajzia
 BANKA CREDINS	2003	Investues Individë – 74.6 % BFSE Holding B.V. – 22.17% SECO – 3.17%	Shqipëri Ndërkombëtar Zvicër
 Emporiki Bank CREDIT AGRICOLE GROUP	1999	Emporiki Bank of Greece Sa - 100%	Greqi
 Fibank First Investment Bank	1999	First Investment Bank Ad Sofia - 99.9998% Të tjerë - 0.0002%	Bulgaria Bulgaria
 INTESA SANPAOLO BANK Albania	1998	Intesa Sanpaolo Group S.P.A. - 90.83% BERZH - 7.78% Società Italiana Imprese All'estero - 1.39%	Itali Ndërkombëtar Itali
 ProCredit Bank	1999	Procredit Holding Ag - 80% Commerzbank Ag - 20%	Gjermani Ndërkombëtar
 Raiffeisen BANK	1991	Raiffeisen International Bank Ag – 100%	Austria
 SOCIETE GENERALE ALBANIA	2004	Societe Generale Group - 85.82% Investues Individë – 14.18%	France Shqipëri
 TIRANA BANK	1996	Piraeus Bank – 96.71% Të tjerë – 3.29%	Greqi Greqi
 UNION BANK	2006	Unioni Financiar Tiranë Sh.P.K - 83.12% BERZH - 12.5% Investues Individë – 4.38 %	Shqipëri Ndërkombëtar Shqipëri
 VENETO BANKA GRUPPO VENETO BANCA	2005	Veneto Banca Holding - 100%	Itali

SHIFRAT E PARAQITURA JANË NË MIJË EURO; 1 EURO = 138.77 LEKË

BANKAT	AKTIVET	HUATË	KAPITALET E VETA	DEPOZITAT	FITIMI NETO	NR. I DEGËVE	NR.I PUNONJËSVE
 ALPHA BANK	474,656	329,903		415,617		47	374
 UBA United Bank of Albania Banka e Bashkuar e Shqipërisë	39,781	16,763	10,760	30,594	(3,053)	6	73
 NBG Bank	329,833	250,497	47,181	211,433	1,325	30	305
 BKT BANKA KOMBETARE TREGITARE	1,126,337	412,977	88,936	981,507	18,713	72	922
 CBA CREDIT BANK OF ALBANIA BANKA E KREDITIT TE SHQIPËRISË	13,123	1,683	9,092	3,510	223	2	30
 Banka Nderkombetare Tregitare International Commercial Bank	51,414	15,776	10,493	36,294	877	8	79
 BANKA CREDINS	511,785	290,107	38,819	447,976	4,809	41	516
 Emporiki Bank CREDIT AGRICOLE GROUP	228,596	162,828	30,280	92,656	903	23	238
 Fibank First Investment Bank	55,797	22,526	7,872	44,488	(1,404)	9	106
 INTESA SANPAOLO BANK Albania	869,295	352,261	91,608	753,796	13,804	32	543
 ProCredit Bank	292,643	167,182	29,563	241,868	752	40	705
 Raiffeisen BANK	1,992,730	770,287	197,688	1,704,483	38,016	103	1,374
 SOCIETE GENERALE ALBANIA	336,331	144,144	37,299	284,816	(1,162)	41	360
 TIRANA BANK	652,580	435,284	95,106	501,452	10,780	56	478
 UNION BANK	153,806	75,827	13,962	121,476	407	30	257
 VENETO BANKA GRUPPO VENETO BANCA	62,923	42,342	11,193	45,867	(831)	8	70



Bylis. Ndërtesë publike e përdorur si arsenal, ose burg. Ndërtuar në mesin e shek III p. Kr dhe rindërtuar në fund të shek. I m. Kr.

V. AKTIVITETI FINANCIAR I AAB-SË



PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2010

AUDITUAR NGA **BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË**

Përmbajtja:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	38
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE.....	39
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARAVE.....	40
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE.....	41

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Më 31 Dhjetor 2010

LEK

	Shënime	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Aktivët			
Arka dhe Banka	4	1,447,168	4,233,936
Totali i Aktiveve Afatshkurtra		1,447,168	4,233,936
Aktivët Afatgjata			
Aktivët e qëndrueshme, neto	5	963,553	1,229,147
Totali i aktiveve Afatgjata		963,553	1,229,147
Totali i aktiveve		2,410,721	5,463,083
Detyrime		2,410,721	5,463,083
TOTALI I DETYRIMEVE		2,410,721	5,463,083

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse 4 deri në 8, si pjesë e pasqyrave financiare.

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010

LEK

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Të ardhurat			
Kuotat e Anëtarësisë	6	16,000,000	16,000,000
Interesi i Bankës		-	-
Të ardhura të tjera		175,000	-
Totali i të Ardhurave		16,175,000	16,000,000
Shpenzimet			
Amortizimi	5	(269,584)	(358,347)
Shpenzimet e Përgjithshme dhe të Administrimit	7	(12,957,778)	(13,745,465)
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të qëndrueshme		-	(51,364)
Donacione për përmbytjet	8	(6,000,000)	
Diferenca nga kursi i këmbimit fitim ose /(humbje)		-	1,565
Totali i Shpenzimeve		(19,227,362)	(14,153,612)
Teprica / (Deficiti) i të Ardhurave ndaj Shpenzimeve		(3,052,362)	1,846,388
Aktivët Neto në fillim të vitit		5,463,083	3,616,695
Aktivët Neto në fund të vitit		2,410,721	5,463,083

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse 4 deri në 8, si pjesë e pasqyrave financiare.

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARAVE

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010

LEK

	Shenime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Fluksi i parave nga veprimtaria e shfrytëzimit			
Diferenca mes të ardhurave dhe shpenzimeve		(3,052,362)	1,846,388
Rregullime për :			
Amortizimin	5	269,550	358,347
Para nga aktivitetet e shfrytëzimit		(2,782,778)	2,256,099
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese			
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	5	(3,990)	(191,481)
Para nga veprimtaritë investuese		(3,990)	(191,481)
Rritja/Rënia neto e mjeteve monetare		(2,786,768)	2,064,618
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	4	4,233,936	2,169,318
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël	4	1,447,168	4,233,936

Pasqyra e rrjedhës së Parave duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse 4 deri në 8, si pjesë e pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare të Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB) janë përpiluar dhe nxjerrë në datë 26.03.2011 dhe nënshkruar në emër të AAB-së nga:

Endrita Xhaferaj
Sekretare e Përgjithshme
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



Ismail BAKIU
Kontroll i Brendshëm
BANKA E KREDITIT TE SHQIPERISE



SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) është themeluar më 15 Prill 1999 me seli në adresën: Blvd. “Dëshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, Kulla I, Kati 6 A. 3, Tiranë, Shqipëri.

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) është një shoqatë jo fitimprurëse, e cila përpiqet të promovojë standardet më të fundit Bankare të anëtarëve të saj, zhvillimin, stabilitetin dhe efektshmërinë e sistemit bankar shqiptar në përgjithësi, duke kontribuar kështu në përparimin e ekonomisë shqiptare. AAB përbëhet nga 16 anëtarë, mbi baza vullnetare: Alpha Bank – Dega në Shqipëri, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Societe General Albania, Banka Credins, Banka e Kreditit të Shqipërisë, Banka Emporiki – Shqipëri, Banka e Parë e Investimeve, Banka Ndërkombëtare Tregtare, Banka Intesa SanPaolo Albania, Veneto Banka, Banka Kombëtare e Greqisë – Dega në Shqipëri, Banka ProCredit, Raiffesien Bank Albania, Banka e Tiranës, Banka Union, Banka e Bashkuar e Shqipërisë.

2. BAZA E PËRGATITJES

Librat dhe regjistrimet kontabël të AAB mbahen sipas një modeli të modifikuar të kontabilitetit me bazë cash-i. Konkretisht, të ardhurat njihen si të tilla pasi arkëtohen dhe jo kur konstatohen dhe shpenzimet njihen kur paguhen dhe jo kur kryhen, me përjashtim të veprimeve lidhur me pajisjet dhe tokat e ndërtesat, të cilat kapitalizohen dhe amortizohen gjatë gjithë periudhës së pritshme të përdorimit. Auditori rekomandon që kontabiliteti të mbahet mbi baza të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL

3.1 Njohja e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

Të ardhurat regjistrohen kur arkëtohen dhe shpenzimet kur paguhen. **Auditori rekomandon që të ardhurat dhe shpenzimet të regjistrohen kur lindin dhe kur kryhet pagesa e tyre.**

3.2 Aktivët e Qëndrueshme

Aktivët e qëndrueshme mbahen me kosto, minus amortizimin e akumuluar. Amortizimi kryhet sipas metodës së vlerës së mbetur, duke shpërndarë koston e pasurisë dhe pajisjeve, përgjatë gjithë periudhës së pritshme të përdorimit të tyre. Amortizimi fillon të regjistrohet që nga muaji pasardhës i atij të blerjes, me normat e mëposhtme:

	Në %
Mobilie	20
Pajisje elektronike	25

3.3 Konvertimi nga Monedha e Huaj

AAB përdor si monedhë bazë Lek-un (ALL). Të gjithë kontributet dhe pjesa dërrmuese e shpenzimeve janë në Lek (ALL). Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kursin e Bankës së Shqipërisë në datën e kryerjes së transaksionit.

3.4 Tatimet dhe taksat

AAB është një shoqëri jo fitimprurëse dhe si e tillë është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin në Shqipëri. AAB është subjekt i tatimit në burim, i tatimit mbi të ardhurat financiare dhe i kontributeve të sigurimeve shoqërore.

4. ARKA DHE BANKA

Arka dhe banka përbëhen nga sa më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Arka	49,372	21,706
Banka	1,397,796	4,212,230
Totali	1,447,168	4,233,936

Banka përbëhet nga sa më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Llogari rrjedhëse		
Në LEK, pranë Intesa SanPaolo Bank	-	4,212,230
Në LEK, pranë Veneto Banka	583,156	-
Në LEK, pranë Union Bank	814,640	-
Totali	1,397,796	4,212,230

5. AKTIVET E QËNDRUESHME

Aktivët e qëndrueshme përbëhen si më poshtë:

	Mobilie / Orendi	Pajisje Elektronike	Totali
Kosto			
Në 31 Dhjetor 2009	1,555,475	992,676	2,548,151
Shtesat gjatë vitit 2010	3,990	-	3,990
Pakësimi gjatë vitit 2010	-	-	-
Në 31 Dhjetor 2010	1,559,465	992,676	2,552,141
Amortizimi i Akumuluar			
Në 31 Dhjetor 2009	797,425	521,579	1,319,004
Amortizimi gjatë vitit 2010	151,809	117,774	269,584
Pakësimet gjatë vitit 2010	-	-	-
Në 31 Dhjetor 2010	949,234	639,353	1,588,587
Vlera Neto e Librit			
Në 31 Dhjetor 2009	758,050	471,097	1,229,147
Në 31 Dhjetor 2010	610,230	353,323	963,553

6. TË ARDHURAT

Të ardhurat e arkëtuara gjatë vitit 2010 dhe 2009 janë si vijon:

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Kuotat e anëtarësimit në LEK	16,000,000	16,000,000
Të ardhura të tjera financiare	175,000	-
Totali	16,175,000	16,000,000

Në të ardhurat e tjera financiare pasqyrohen të ardhura të tjera të marra për dhënien me qira të sallës së mbledhjeve, si edhe derdhjet e tjera të anëtarëve gjatë vitit 2010 për donacionin e kryer në fund të vitit 2009 për institucionin e fëmijëve SHKEJ.

7. SHPENZIMET E PËRGJITHSHME DHE TË ADMINISTRIMIT

Shpenzimet e përgjithshme dhe të administrimit përbëhen kryesisht nga Shpenzimet e personelit dhe shpenzime të tjera të administrimit të zyrës së Sekretariatit si edhe shpenzime organizative.

Shpenzimet e personelit paraqiten si më poshtë:

Kosto e punës	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Pagat e personelit	5,305,603	3,977,925
Shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	438,882	1,241,841
Totali	5,744,485	5,219,766

Shpenzimet e tjera të administrimit në 2010 dhe 2009 përbëhen nga sa vijon:

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Shërbime Utilitare	4,461,160	4,640,025
Shpenzime Organizative	1,317,331	2,248,268
Shpenzime zyre	554,026	482,930
Reklama & Internet	752,421	1,094,617
Komisione & Tarifa Bankare	88,855	23,030
Taksa Vendore	39,500	36,829
Totali	7,213,293	8,525,699

8. DONACIONET

Me vendim të Asamblesë së Anëtarëve të AAB-së, në dhjetor të 2010 u dhurua shuma prej 6 milionë lekë nga fondet e AAB për zonat e përmbytura në veri të vendit.

